

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6076
E enjte, 30 korrik 2020
çmimi 0.40 €

Rënie e lehtë e rasteve me Covid, 194 raste të reja



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

SUGJERIMET PËR DIALOG S'DUHET TË SHIHEN SI KËRCËNIM PËR KOALICIONIN



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), deputeti Pal Lekaj, ka bërë me dije se kryeministri Avdullah Hoti duhet të jetë më insistues për praninë amerikane në dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai është shprehur i bindur se nuk mund të ketë marrëveshje përfundimtare pa praninë e Uashingtonit zyrtar. Lekaj ka deklaruar se sugjerimet e AAK-së për kryeministrin rreth këtij procesi nuk duhet të shihen si kërcënime për prishje të koalicionit. Sipas tij, këto sugjerime duhet të shihen si këshilla që procesi i dialogut të drejtohet në rrugën e duhur

Shkruan:
Kudusi LAMA



RIMËKËMBJE APO KOLAPS EKONOMIK? ÇFARË DO TË THONË HISTORIANËT PËR NE?

Nora HASANI

AKTUALE

KOORDINATORI PËR DIALOG TAKON HOXHAJN E LIMAJN, KËRKON UNITET NË KËTË PROCES

EKONOMI

NË GJASHTËMUJORIN E PARË SHPENZIMET U RRIËN PËR 38.7 MILIONË EURO

KOMISIONI EVROPIAN DISBURSON 9.9 MILIONË EURO NË BUXHETIN E KOSOVËS



SPORT

PRISHTINA FITON KUPËN DHE SIGURON DALJEN NË EVROPË

QEVERIA MIRATON NJË VARG MASASH TË REJA KUNDËR COVID-19

Me masat e reja të qeverisë, duke filluar nga ora 22:30 deri në orën 05:00, ndalohet çfarëdo qarkullimi i personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në komunat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Podujevë, Gjakovë, Ferizaj, Lipjan,

Drenas, Vushtrri, Mitrovicë e Jugut, Gjilan, Fushë-Kosovë dhe Shtërpçë, përveç në raste urgjente. Kurse subjekteve që ofrojnë shërbime të gastronomisë (restorantet, kafiteritë, klubet e natës etj.) u ndalohet

funksimi nga ora 22:30 deri në 05:00. Jashtë këtij orari mund të punojnë vetëm në hapësira të hapura, duke respektuar largësinë prej dy metrash ndërmjet tavolinave, si dhe shërbimet take-away (merre me vete)



PRESIDENTI THAÇI DEKORON ME URDHRIN 'HERO I KOSOVËS', QERIM KELMENDIN

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Trumpi përmend sërish hidroksiklorinën si trajtim për koronavirus

WASHINGTON, 29 KORRIK - Presidenti amerikan Donald Trump ka mbrojtur sërish përdorimin e ilaçit për malarien, hidroksiklorinën, si trajtim për koronavirusin, duke qëndruar mbrapa

vendimit të tij për të shpërndarë disa video në rrjetin social, "Twitter", që promovojnë ilaçin në fjalë. Hidroksiklorina është larguar nga lista e ilaçeve për parandalim apo trajtim të

sëmundjes Covid-19. Mirëpo Trump, që shumë herë në të kaluarën ka treguar mbështetje për hidroksiklorinën, ka thënë më 28 korrik, se ai beson që ilaçi ka pasur efekt "në fazat e para".



Veliu viziton veriun, informohet për gjendjen në këtë pjesë

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINE, 29 KORRIK - Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, i shoqëruar nga zëvendësministri i MPB-së, Milan Radojeviq dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, kanë vizituar të mërkurën Komunën e

Zubin Potokut, Stacionin Policor në këtë komunë, si dhe pikën kufitare në Bërnjak. Me këtë rast, ministri Veliu u njoftua për së afërmi me punën dhe aktivitetet e këtyre institucioneve, sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet Komuna e Zubin Potokut, zyrtarët policorë në këtë komunë, si dhe policët dhe zyrtarët e tjerë kufitarë, në

veçanti gjatë kësaj kohe të menaxhimit të pandemisë Covid-19.

Me kryetarin e Komunës së Zubin Potokut, Srdjan Vuloviq, u bisedua mbi thellimin e bashkëpunimit të kësaj komune me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet shtetërore në përgjithësi, në veçanti për nevojën e

përforcimit të bashkëpunimit dhe të besimit të qytetarëve të kësaj komune në institucionet tona.

Ministri Veliu u prit edhe nga komandanti i Stacionit Policor, Zvezdan Milivojeviq, i cili e falënderoi ministrin për vizitën në komunën e tyre, njëkohësisht kërkoi që t'u mundësohet ndërtimi i stacionit të ri policor

në këtë komunë.

Ndërkaq në pikën kufitare të Bërnjakut, ministri Veliu pa nga afër punën që po bëjnë policët kufitarë dhe doganierët për qarkullimin e mallrave dhe njerëzve mes dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, por edhe për zbatimin e rregullave të pandemisë ashtu si në të gjitha pikat e tjera kufitare.



Parlamenti turk miraton legjislacionin për kontrollim të rrjeteve sociale



ANKARA, 29 KORRIK - Parlamenti i Turqisë ka miratuar të mërkurën legjislacionin për rregullim të rrjeteve sociale siç janë "Twitter" dhe "Facebook", duke i detyruar këto të fundit

të veprojnë në përputhje me kushtet e ashpra, në të kundërtën do të gjobiten apo do t'iu kufizohet aktiviteti. Sipas legjislacionit, kompanitë e mëdha të rrjeteve

sociale, "Facebook" dhe "Twitter", duhet të kenë zyrat e tyre përfaqësuese në Turqi për t'i trajtuar ankesat kundër përmbajtjes në këto platforma. Legjislacioni i ri u

kërkon ofruesve të këtyre shërbimeve që t'i ruajnë të dhënat në Turqi, duke e bërë më të lehtë qasjen në to nga prokurorët dhe autoritetet e tjera.

Vdes nga Covid-19 ministri për Çështjet e Veteranëve të Bosnjës

Sarajevë, 29 korrik - Ministri për Çështjet e Veteranëve në Federatën e Bosnjës-Hercegovinës, Salko Bukvareviq, ka

vdekur të mërkurën pas përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, meqë ditë më parë kishte rezultuar pozitiv në testin për koron-

avirus. Vdekjen e tij e ka konfirmuar Qendra Klinike e Universitetit të Sarajevës. Nga dita e hënë ai ka qenë

duke u trajtuar me respirator. Bukvareviq, 53-vjeçar, ka qenë ministër në Bosnje-Hercegovinë nga viti 2015.



Rënie e lehtë e rasteve me Covid, 194 raste të reja



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit kanë vdekur edhe katër persona me Covid-19, duke e çuar në 196 numrin e përgjithshëm të të vdekurve nga ky virus. Po ky institut ka bërë me dije se në 24-orëshin e fundit janë paraqitur edhe 194 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 138 persona

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 KORRIK - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar për 194 raste të reja me Covid-19 në 24 orët e fundit dhe për 138 persona të shëruar. Po ashtu, ky institut ka njoftuar se në 24 orët e fundit kanë ndërruar jetë edhe katër persona të cilët kanë qenë të prekur nga Covid-19. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 449 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 194 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 7 846 raste nga 35

570 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 196 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 138 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 4 267 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 383", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se Prishtina vazhdon të prijë me numrin më të madh të rasteve të reja me Covid-19. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 81 raste, komuna Podujevë 17 raste, Prizren 14 raste, komuna Fushë Kosovë 13 raste, komuna Gjakovë 12 raste, komuna Vushtrri 8 raste, komuna Drenas 7 raste, komuna Mitrovicë 7 raste, komuna Malishevë 5 raste, komuna

Obiliq 5 raste, komuna Lipjan 5 raste, komuna Dragash 4 raste, komuna Skenderaj 4 raste, komuna Ferizaj 3 raste, komuna Gjilan 2 raste, komuna Suharekë 2 raste dhe me nga 1 rast komunat: Istog, Klinë, Pejë, Rahovec dhe Zubin Potok", ka njoftuar ky institut.

Më tutje, IKShPK-ja ka përsëritur apelin bërë qytetarëve, duke kërkuar nga ta që t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19. "Të nderuar qytetarë, virusi është kudo. Ju lutemi përmbahuni rekomandimeve. Virusi vret! Zbatimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta bëjë çdo qytetar i Republikës së Kosovës

që të ruajë veten, të afërmit dhe të tjerët. Bartja e maskave mbetet obliguese. Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se vendi është duke shkuar drejt një normaliteti të ri. "Ky normalitet i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të mirë, për ta mbajtur higjienën, për ta mbajtur distancën, për ta mbajtur maskën, për të mos përhapur piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmit, të familjes, të fëmijëve, të farefisit, të komunitetit, pastaj të të gjithë qytetarëve. Inspektoratet sanitare të AUV-it dhe inspektoratet komunale bashkë me shtabet komunale patjetër duhet ta zbatojnë Ligjin për

Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse duke u mbështetur në manualin për luftimin e Covid-19 dhe të merren masa përgjegjësie në çdo rast të moszbatimit eventuale të rekomandimeve të Institutit Kombëtar", ka njoftuar ky institut.

Sipas këtij instituti, çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve. "Nuk ka të drejtë askush ta rrezikojë jetën e të afërmit të tyre, të moshuarve dhe personave me sëmundje kronike për shkak të pakujdesit dhe moszbatimit të rekomandimeve. Vazhdoni ta mbani distancën fizike dhe maskat. Lani duart me kujdes disa herë në ditë nga 20-30 sekonda. Lehtësimi i masave është bërë për të na bërë më të përgjegjshëm. Ju lutem të keni kujdes, sepse ende ekziston rreziku i përhapjes në vendet ku ka grumbullim të madh të njerëzve. Ne po punojmë për ju, andaj na ndihmoni pak që t'ju ndihmojmë shumë", ka njoftuar IKShPK-ja.

Qeveria ndan nga 300 euro për personelin mjekësor

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Kabineti qeveritar të mërkurën ka miratuar vendimin për aprovim të shtesave mujore për personelin shëndetësor, për angazhim shtesë në muajin

korrik dhe gusht të vitit 2020 dhe për ekspozim të drejt-përdrejtë ndaj rrezikut të infeksionit në punë e tyre gjatë trajtimit të pacientëve me virusin Covid-19. Sipas vendimit, personeli shëndet-

tësor, sipas kriteve të paracaktuara, do ta përfitojë shtesën prej 300 eurosh. Po në këtë mbledhje të qeverisë, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka informuar kabinetin qeveritar për

zbatimin e vendimeve dhe masave të qeverisë për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19. Pas informatës së hollësishme të ministrit, kryeministri ka kërkuar që të aktivizohet

Plani i Reagimit Kombëtar dhe të sigurohet një koordinim sa më i mirë i veprimit ndër-institucional për zbatimin e masave për parandalim dhe luftim të pandemisë Covid-19.



Flet për “Epokën e re”, Pal Lekaj

Sugjerimet për dialog s’duhet të shihen si kërcënim për koalicionin

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), deputeti Pal Lekaj, ka bërë me dije se kryeministri Avdullah Hoti duhet të jetë më insistues për praninë amerikane në dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai është shprehur i bindur se nuk mund të ketë marrëveshje përfundimtare pa praninë e Uashingtonit zyrtar. Lekaj ka deklaruar se sugjerimet e AAK-së për kryeministrin rreth këtij procesi nuk duhet të shihen si kërcënime për prishje të koalicionit. Sipas tij, këto sugjerime duhet të shihen si këshilla që procesi i dialogut të drejtohet në rrugën e duhur

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 29 KORRIK - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka deklaruar se sugjerimet e kësaj partie për dialogun Kosovë - Serbi ndaj kryeministrit Avdullah Hoti nuk duhet të shihen si kërcënim për prishje të koalicionit. Ai ka vlerësuar se këto sugjerime duhet të shihen si këshilla që të drejtohet në rrugën e duhur procesi i dialogut.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se në këtë proces duhet të garantohet përmbyllja përfundimtare e problemeve

Kosovë - Serbi. “Dyshimet që ka përcjellë AAK-ja te partneri i koalicionit janë se ne po frikësohemi se Bashkimi Evropian po na kthen në vitin 2011 ku bisedohej për çështje teknike dhe jemi të bindur se nuk mund të ketë marrëveshje pa praninë e Uashingtonit zyrtar. Këto sugjerime të AAK-së nuk duhet të shihen si kërcënime për koalicionin, por si këshilla që të drejtohem në rrugën e duhur ku garantohet përmbyllja përfundimtare e problemeve Kosovë - Serbi”, ka thënë Lekaj.

Ai ka bërë me dije se në këtë proces kryeministri Hoti duhet të jetë më insistues për praninë amerikane në tavolinën e

dialogut të Brukselit. “Kryeministri Hoti në dialog duhet të shkojë për ta marrë njohjen e Serbisë duke u bazuar në Deklaratën e Pavarësisë së 17 shkurtit 2008 dhe në asnjë formë të hyjë në një dialog të pafund që do ta linte Kosovën në status kohe dhe, siç duket, pa praninë e ShBA-së nuk ka garanci që marrëveshja do të arrihet shpejt andaj z. Hoti duhet të jetë më shumë insistues për praninë amerikane në tavolinën e dialogut”, është shprehur ai.

Në këtë intervistë, ai ka folur edhe për proceset e tjera me të cilat po përballet Kosova. Sipas Lekajt, për procesin e dialogut,

Gjykatën Speciale dhe menaxhimin e pandemisë, kërkohet unitet nga i gjithë spektri politik. Lekaj ka treguar se AAK-ja nuk kundërshton mundësinë e zgjerimit të koalicionit qeverisës. “Në situatën në të cilën jemi duke iu referuar sfidave që theksova më lart, AAK-ja nuk është kundër çfarëdo përfshirje që do ta stabilizonte dhe unifikonte politikën e Kosovës përballë çfarëdo sfide të mundshme në të ardhmen”, ka thënë Lekaj.

“Epoka e re”: Z. Lekaj, qeveria aktuale po i bën dy muaj që ka marrë mandatin. Cili është vlerësimi juaj për këtë qeveri? A po i përmbush pritjet e AAK-së?
Lekaj: Qeveria aktuale duhet vlerësuar për angazhimin e saj sepse erdhi në një kohë të rënduar, në pandemi dhe, përkundër kësaj, përkushtimi i saj nuk ka munguar. Ne vlerësojmë përpjekjet e saj për ta vendosur situatën në binarët e duhur, edhe pse ky duket një proces shumë i ngadalshëm dhe i mundimshëm që kërkon

angazhim individual të secilit për respektimin e masave anti Covid-19. AAK-ja pret që me rishikimin e buxhetit të lehtësohet puna e qeverisë dhe shumë shpejt ta fillojmë aplikimin e masave që do ta mundësonin rimëkëmbjen ekonomike.

“Epoka e re”: Së fundi janë shprehur disa mospajttime në mes të AAK-së dhe LDK-së. Këto mospajttime sa mund ta rrezikojnë këtë koalicion qeverisës?

Lekaj: AAK-ja angazhohet si gjithmonë për dialog që do të përfundonte në njohje reciproke dhe marrëveshje përfundimtare ligjrisht të obligueshme. Dyshimet që ka përcjellë AAK-ja te partneri i koalicionit janë se ne po frikësohemi se Bashkimi Evropian po na kthen në vitin 2011, ku bisedohej për çështje teknike dhe jemi të bindur se nuk mund të ketë marrëveshje pa praninë e Uashingtonit zyrtar. Këto sugjerime të AAK-së nuk duhet të shihen si

duhet të shkojë për ta marrë njohjen e Serbisë duke u bazuar në Deklaratën e Pavarësisë së 17 shkurtit 2008 dhe në asnjë formë të hyjë në një dialog të pafund që do ta linte Kosovën në status kohe dhe, siç duket, pa praninë e ShBA-së nuk ka garanci që marrëveshja do të arrihet shpejt andaj z. Hoti duhet të jetë më shumë insistues për praninë amerikane në tavolinën e dialogut.

“Epoka e re”: Derisa Kosova pritet të përballet me procese shumë të rëndësishme, si dialogu me Serbinë, Gjykatën Speciale, qeveria aktuale duket e brishtë në numra. A është e gatshme kjo qeveri të përballet me këto sfida?

Lekaj: Proceset dhe problemet me të cilat po përballet Kosova këto që po i përmendni ju, edhe pandemia Covid-19 nuk janë të menaxhueshme vetëm me një shumicë të thjeshtë prej 61 deputetësh. Këtu kërkohet unitet i gjithë spektrit politik që do ta mundësonte daljen e shtetit të Kosovës edhe më të fortë dhe të vendosur.

“Epoka e re”: Si skenar i mundshëm është përmendur edhe mundësia e përfshirjes së PDK-së në qeveri. E përkrah AAK-ja një gjë të tillë?

Lekaj: Në situatën në të cilën jemi duke iu referuar sfidave që theksova më lart, AAK-ja nuk është kundër çfarëdo përfshirje që do ta stabilizonte dhe unifikonte politikën e Kosovës përballë çfarëdo sfide të mundshme në të ardhmen.

kërcënime për koalicionin, por si këshilla që të drejtohem në rrugën e duhur ku garantohet përmbyllja përfundimtare e problemeve Kosovë - Serbi.

“Epoka e re”: Çfarë nuk po shkon në këtë proces dhe çfarë duhet të bëjë kryeministri?

Lekaj: Siç theksova më lart, kryeministri Hoti në dialog

Osmani e pret në takim lamtumirës ambasadorin zviceran



PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim lamtumirës ambasadorin zviceran në Kosovë, Jean-Hubert Lebet, me rastin e përfundimit të misionit të tij diplomatik në Kosovë. Kryetarja Osmani e ka falënderuar ambasadorin Lebet për punën e shkëlqyer si përfaqësues i Zvicrës në Kosovë si dhe për angazhimin aktiv dhe përmbytësor gjatë misionit të tij diplomatik.

Osmani ka shprehur mirënjohje për ndihmën që shteti i Zvicrës i ka ofruar Kosovës në

pandemi dhe për mbështetjen jashtëzakonisht të vlerësuar për përbashkëtimin e kësaj sfide të përbashkët. Të dyja palët u morën vesh që për një menaxhim të suksesshëm të kësaj situatë, rimëkëmbja ekonomike dhe kujdesi për shëndetin e qytetarëve duhet të jenë prioritetet paralele sepse, siç theksuan ata, pa shëndet të qytetarëve nuk ka as zhvillim ekonomik dhe anasjelltas.

Për më tepër, kryetarja Osmani ka theksuar se gjatë misionit diplomatik të Hubert është vërejtur prani më dinamike e Zvicrës në Kosovë në fushat dhe temat që prekin përdit-

shmërinë e qytetarëve të Kosovës, në mesin e të cilave ka veçuar luftimin e korrupsionit dhe mbështetjen për promovimin dhe avancimin e të drejtave të grupeve të marginalizuara.

Me këtë rast, kryetarja Osmani e ka uruar ambasadorin Lebet me rastin e Ditës Kombëtare të Zvicrës. Në fund, kryetarja Osmani i ka uruar ambasadorit Lebet suksese në angazhimin e mëtejshëm dhe e ka siguruar atë që institucionet e Kosovës do të jenë mikpritëse ndaj pasardhësit të tij për ta vazhduar bashkëpunimin në mes të Kosovës dhe Zvicrës.



Votohet Ligji anti Covid në Komision, procedohet për Kuvend

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, nën kryesimin e Albena Reshitajt, kryetare, ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, në të cilën ka shqyrtuar Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës. Projektligji është iniciuar nga kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, me mbështetjen e pesë deputetëve të tjerë.

Kryetarja e komisionit, Reshitaj, pasi ka shfaqur shqetësimin e saj për gjendjen e rëndë në të cilën gjendet vendi ynë, si rezultat i pandemisë Covid-19, këtë iniciativë ligjore e ka konsideruar të një rëndësie të veçantë. Pas diskutimeve, me pajtimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, projektligji në fjalë është përkrahur në parim, duke u proceduar më tutje për shqyrtim në seancë plenare.



Presidenti Thaçi dekoron me urdhrin 'Hero i Kosovës' Qerim Kelmendin

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Presidenti Hashim Thaçi ka dekoruar të mërkurën me urdhrin “Hero i Kosovës” të ndjerin Qerim Kelmendi. Këtë dekoratë e ka pranuar vajza e tij, Era Kelmendi dhe bashkëshortja e tij, Arjeta. I pranishëm në ndarjen e kësaj dekorate ishte edhe vëllai i Qerimit, Osman Kelmendi.

Qerim Kelmendi ishte një prej ushtarëve të parë të UÇK-së i cili ka dhënë kontribut të çmuar në çlirimin e Kosovës. Ai u vra më 27 shkurt të këtij viti në rrethana ende të panjohura. Trupi i Qerim Kelmendit u gjet i djegur në veturën e tij në fshatin Zahaq të Komunës së Pejës.

Koordinatori për dialog takon Hoxhajn dhe Limajn, kërkon unitet në këtë proces

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 KORRIK - Koordinator i Shtetëror për Dialog, Skender Hyseni, ka takuar të mërkurën anëtarin e kryesisë së PDK-së, deputetin Enver Hoxhaj, të cilin e ka

informuar për takimet e fundit për dialogun Kosovë - Serbi. Ai e ka njoftuar Hoxhajn me rrjedhën e takimeve që ka pasur në Bruksel me zyrtarët serbë. "Theksuam nevojën e koordinimit të ngushtë dhe bashkërendimit në këtë dhe të gjitha çështjet e tjera të

rëndësisë nacionale duke ndërtuar unitet dhe konsensus sa më të gjerë politik në Kosovë!", ka deklaruar Hyseni. Po për këtë temë Hyseni ka takuar edhe kryetarin e Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. Hyseni ka bërë me dije se me Limajn kishin pajtim të plotë për nevojën e koordinimit të ngushtë dhe bashkërendimit në këtë temë. "Vlerësoj tej mase përkushtimin dhe angazhimin e z. Limaj për unitet sa më të fuqishëm politik në Kosovë", ka deklaruar Hyseni.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, më 21 korrik ka emëruar Skender Hysenin në postin e koordinatorit shtetëror në dialogun me Serbinë. "Duke u bazuar në platformën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për dialogun me Serbinë, në mbështetje të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 1 korrik 2020, me qëllim të organizimit dhe të



bashkërendimit institucional dhe ndërkombëtar të këtij procesi, kryeministri Avdullah Hoti sot ka emëruar Skender Hysenin koordinator shtetëror për dialog", është thënë në njoftimin e qeverisë. Koordinator i për dialogun, me këtë rast Skender Hyseni,

pritet ta udhëheqë Këshillin e Ekspertëve pranë Zyrës së Kryeministrit. Detyrë e këtij këshilli, i cili u formua në fillim të korrikut, do të jetë përpilimi i analizave specifike dhe këshillimi i kryeministrit dhe qeverisë për çështjen e dialogut me Serbinë.



Mbahet takimi i grupit punues për finalizimin e Projekt-Kodit të Procedurës Penale


PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Grupi Punues i Ministrisë së Drejtësisë për finalizimin e Projekt-Kodit të Procedurës Penale të mërkurën ka mbajtur takim të radhës në të cilin ka marrë pjesë edhe ministri Selim Selimi.

Gjatë këtij takimi është diskutuar për disa çështje me rëndësi, duke përfshirë çështjen e gjyqësorit në mungesë, suspendimin nga puna të zyrtarëve publikë me rastin e ngritjes së aktakuzës, në pajtim me rekomandimet e Komisionit të Venecias, si dhe mundësinë e përfshirjes së dispozitës që lejon mbajtjen e seancave online, në rrethanat e ngjashme sikurse ballafaqohemi aktualisht me Covid-19.

Ministri Selimi i siguroi mbështetje grupit punues për finalizimin e Projekt-Kodit të

Procedurës Penale, duke shtuar se ky Projekt-Kod është i domosdoshëm për avancimin e legjislacionit për sistemin e drejtësisë. "Finalizimi i Projekt-Kodit të Procedurës Penale është ndër prioritetet e mia, për faktin se miratimi i Kodit të Procedurës Penale adreson sfidat me të cilat është ballafaquar dhe ballafaqohet sistemi ynë gjyqësor dhe prokurorial, andaj është përgjegjësi e jona që këtyre sfidave t'u gjejmë zgjidhje, duke avancuar legjislacionin", ka thënë ministri Selimi. Procesi i hartimit të Projekt-Kodit të Procedurës Penale është mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në takimin e kryesuar nga drejtori i Departamentit Ligjor, njëherësh kryesues i grupit punues, Ardian Bajraktari, të



pranishëm ishin edhe gjyqtarë, prokurorë, avokatë, përfaqësues nga shoqëria civile, si dhe aktorë të tjerë

vendorë dhe ndërkombëtar. Ministria e Drejtësisë do të angazhohet që të bëhet sa më parë finalizimi i Projekt-Kodit

të Procedurës Penale, si dokument mjaft me rëndësi, i cili i adreson sfidat e sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial.

Kosnetti kritikon Projektligjin e propozuar për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se Ligji i propozuar për vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës "është mënyrë e gabuar për të treguar respekt për UÇK-në". "Ai e kriminalizon fjalën e lirë, i frikëson

qytetarët dhe është i kushtueshëm. Ai devijon nga përpjekjet praktike për të kuptuar dhe mësuar historinë e Kosovës", ka shkruar Kosnett në llogarinë e vet "Twitter", pa dhënë më shumë hollësi.

Më 14 korrik Qeveria e Kosovës ka mbështetur

Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së, duke e proceduar në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës.

Projektligji, i propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës, parasheh përcaktimin e obligimit institucional dhe qytetar për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së.



Qeveria miraton një varg masash të reja kundër Covid-19

Me masat e reja të qeverisë, duke filluar nga ora 22:30 deri në orën 05:00, ndalohet çfarëdo qarkullimi i personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në komunat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Podujevë, Gjakovë, Ferizaj, Lipjan, Drenas, Vushtrri, Mitrovicë e Jugut, Gjilan, Fushë-Kosovë dhe Shtërpçë, përveç në raste urgjente. Kurse subjekteve që ofrojnë shërbime të gastronomisë (restorantet, kafiteritë, klubet e natës etj.) u ndalohet funksionimi nga ora 22:30 deri në 05:00. Jashtë këtij orari mund të punojnë vetëm në hapësira të hapura, duke respektuar largësinë prej dy metrash ndërmjet tavolinave, si dhe shërbimet take-away (merre me vete)

shëndetësore, nevoja për t'u kujdesur për të sëmurë, kërkimi i ndihmës nga institucionet përkatëse, vdekja e anëtarit të familjes.

Vendimi i obligon të gjithë banorët e Republikës së Kosovës që t'i bartin maskat në fytyrë në të gjitha veprimtaritë jashtë shtëpive/banesave të tyre dhe të mbajnë distancë fizike prej dy metrash në mjedise të përbashkëta jashtë shtëpive/banesave të tyre. Po ashtu, ndalohen të gjitha tubimet publike, përfshirë ahengjet familjare private, si dhe grumbullimi i më shumë se pesë personave në sheshe publike, parqe e të tjera.

Pjesëmarrja fizike e qytetarëve në të gjitha ceremonitë dhe veprimtaritë fetare në tërë territorin e Republikës së Kosovës ndalohet, gjithashtu. Nga subjektet që ofrojnë transport publik (autobusë, kombi, taksi) kërkohet që të punojnë me përgjysmim të kapaciteteve të tyre sa i përket numrit të udhëtarëve që bartin, për ta lejuar hapësirën e

nevojshme për çdo udhëtar. Subjekteve që ofrojnë shërbime të gastronomisë (restorantet, kafiteritë, klubet e natës etj.), u ndalohet funksionimi nga ora 22:30 deri në 05:00, në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Jashtë këtij orari mund të punojnë vetëm në hapësira të hapura, duke respektuar largësinë prej dy metrash ndërmjet tavolinave, si dhe shërbimet take-away (merre me vete), thuhet në vendim.

Po sipas vendimit, ushtrimi i veprimtarisë së çerdheve publike dhe private në tërë territorin e Republikës së Kosovës do të lejohet pas vlerësimit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet komunale.

Vendimi u tha se hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit, me përjashtim të pikës 8 - ku parashihet ndalimi i veprimtarive rekreative, kulturore dhe sportive në mjedise të mbyllura dhe të hapura në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës - e cila hyn në fuqi më 30 korrik 2020.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për disa masa të reja që synojnë ndaljen e përhapjes së Covid-19. Masat kryesisht kanë të bëjnë me kushtet e hyrjes në Kosovë, me kufizimin e lëvizjes në disa komuna, me veshjen e maskave dhe me tubimin e numrit të caktuar të njerëzve. Me vendimin e ri, të gjithë qytetarët e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, të cilët hyjnë në

territorin e Republikës së Kosovës, duhet të dëshmojnë se janë të shëndoshë nga Covid-19, me anë të testit RT-PCR, sipas parimit të reciprocitetit.

Përjashtim nga kjo masë bëjnë disa kategori, përfshirë: personat që hyjnë në transit nëpërmjet Aeroportit Ndërkombëtar "Adem Jashari"; personat që hyjnë në pikat kufitare tokësore, me qëllim të daljes nëpër pikat ajrore nga Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari"; transportuesit profesionistë (voztësit); personat që hyjnë me transport

të organizuar me autobusë ose linjë të rregullt ndërkombëtare tranzite, si dhe diplomatët e shteteve të rajonit të cilët janë të akredituar në Kosovë ashtu sikurse edhe familjarët e tyre.

Me vendimin e qeverisë, duke filluar nga ora 22:30 deri në orën 05:00, po ashtu ndalohet çfarëdo qarkullimi i personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në komunat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Podujevë, Gjakovë, Ferizaj, Lipjan, Drenas, Vushtrri, Mitrovicë e Jugut, Gjilan, Fushë-Kosovë dhe Shtërpçë, përveç në raste të caktuara, si: urgjenca



Qytetarëve të Shqipërisë dhe të Luginës nuk u kërkohet testi për Covid-19

Prishtinë, 29 korrik (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka takuar të mërkurën ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, të cilit i ka konfirmuar se qytetarëve të Shqipërisë që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës nuk u kërkohet testi për

Covid. "I konfirmova ambasadorit Minxhozi se qytetarëve të Republikës së Shqipërisë që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës nuk u kërkohet testi për Covid-19. Vendimi i Qeverisë së Kosovës është i bazuar në parimin e reciprocitetit. Si rrjedhojë, nuk kërkohen tes-

time nga qytetarët e Kosovës dhe të Shqipërisë dhe as nga bashkëqytetarët tanë nga Lugina e Preshevës. Bashkë me ambasadorin Minxhozi u zotua se do ta vazhdojmë bashkëpunimin e ngushtë mes dy shteteve", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Rimëkëmbje apo kolaps ekonomik? Çfarë do të thonë historianët për ne?

Në çdo krizë ka një mundësi. Kosova para vetes ka mundësi unike të cilën po nuk e kapi tani, nuk do ta ketë më. Plani i rimëkëmbjes ekonomike nuk duhet të shërbejë vetëm si levë për ta rifilluar ekonominë, por për ta ndërtuar një ekonomi të së ardhmes, që mbështetet në digjitalizim dhe ekonomi të gjelbër.

Nora HASANI

Pandemia e ka zhytur botën në kohën më të errët e më sfiduese me të cilën është ballafaquar ndonjëherë. Në ekonomi ka shkaktuar turbulencën e përmasave aq të mëdha sa që pritet të lërë pasojë më të thella se ato të "Depresionit të Madh" të viteve '30. Fondi Monetar Ndërkombëtar parashikon tkurrje të ekonomisë botërore prej 3 përqindësh këtë vit - një zbritje prej 6.3 pikë përqindjeje vetëm për katër muajt e fundit. Sipas "Financial Times", borxhi i qeverive në nivel global ka arritur tashmë nivelin e tij më të lartë në kohë paqeje e krahas saj po rritet edhe papunësia.

Si pasojë e pandemisë dhe masave të ndërmarra për parandalimin e saj, shumë punëtorë kosovarë humbën vendet e tyre të punës. Instituti GAP në raportin "Ndikimi i pandemisë Covid-19 në tregun e punës" thotë se vetëm në muajin prill 2020 janë regjistruar 32 377 punëkërkues të rinj. Për t'u përballur më lehtë me ndikimin negativ të Covid-19 në shëndetësi e ekonomi, kërkohet qeverisje më e ndërgjegjshme dhe efektive, kërkohen veprime të shpejta e të menduara mirë dhe, mbi të gjitha, bashkëpunim gjithëpërfshirës dhe konstruktiv. Duke lënë anash kritikën, dallimet në ideologji, inatet e ndasitë - të gjithë duhet të ulen rreth një tavoline për t'i

përkrahur shëndetësinë dhe ekonominë. Në një situatë të rënduar politike, ku politikëbërësit dhe ligjvënësit janë përqendruar në diskutime të ashpra rreth dialogut me Serbinë, ekonomia është në prag të kolapsit.

Shumica e bizneseve janë duke operuar nën pikën e rentabilitetit. Me rifillimin e pagesave të kësteve, kamatave dhe tatimeve është rënduar edhe më shumë likuiditeti edhe i kompanive më të mëdha në vend - e mos të flasim për bizneset e vogla. Kriza e vërtetë i ka goditur bizneset tani. Tre muajt e ardhshëm do të jenë vendimtarë për mbijetesën e bizneseve. Deri më sot përkrahja qeveritare për sektorin privat ishte e zbehtë, pa ndonjë efekt të dukshëm. E patëm një pako emergjente, me karakter kryesisht social, që nuk u implementua në tërësi dhe tani në Kuvend ndodhet projektligji për rimëkëmbje ekonomike. Duke i ditur problemet në funksionimin e legjislativit, mbretëron një pasiguri nëse projektligji që është i ndërlydhur me rishikimin e buxhetit dhe që parasheh një intervenim prej 1.2 miliard eurosh do ta marrë miratimin e përfaqësuesve të popullit.

Si doni që të mbaheni në mend?

Një gjë tanimë është e qartë - bota, siç e njihim para virusit, nuk ekziston më. Kjo pandemi ka goditur aq fortë



saqë nuk ka se si të mos lërë pasojë afatgjatë. Duhet të adaptohemi me normalitetin tonë të ri dhe të bashkëjetojmë me virusin. Rruga për t'u përshtatur këtij normaliteti duhet të ketë një drejtim të qartë, përndryshe do të gjykohej nga historia.

Çfarë do të thonë historianët për ne? A do të thonë që kjo periudhë ishte momenti vendimtar i rimëkëmbjes së ekonomisë së Kosovës? A do ta vlerësojnë qeverisjen aktuale si qeverisje me vizion që arriti ta riorientojë Kosovën dhe ekonominë e saj? Apo do të mbahet në mend si një qeveri që nuk e pati fare fokusin tek ekonomia? Apo ndoshta do të mbahet mend vetëm si qeveria që e lejoi tërheqjen e 10 për qind nga Trusti Pensional për ta rritur kërkesën agregate në përpjekje për ringjallje të ekonomisë?

Në çdo krizë ka një mundësi. Kosova para vetes ka mundësi unike të cilën po nuk e kapi tani nuk do ta ketë më. Plani i rimëkëmbjes ekonomike nuk duhet të shërbejë vetëm si levë për ta rifilluar ekonominë, por për ta ndërtuar një ekonomi të së ardhmes, që mbështetet në digjitalizim dhe ekonomi të gjelbër.

Ky është çasti kur duhet ta definojmë Kosovën që duam. Ta kthejmë fokusin në shpëtimin e ekonomisë sonë edhe ashtu të brishtë. Të mendo-

jmë në mënyrë strategjike duke ndryshuar strukturën e ekonomisë sonë përmes politikave të mirëfillta ekonomike dhe stimujve fiskalë. E çfarë kemi për të humbur, nëse së paku nuk provojmë?

Me përfshirjen e një agjende të gjelbër në rimëkëmbjen ekonomike, Kosova mund t'i përmbushë objektivat e saj për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme. Kjo do të krijojë më shumë vende të reja pune, siç bëri Gjermania gjatë Energiewende. Një shtytje e madhe do të mund t'i jepej sektorit të energjisë së ripërtëritshme me disa hapa shumë konkretë: zvogëlimi apo heqja e TVSh-së për panele solare dhe eliminimi i barrierave burokratike që kompanitë e këtij sektori i hasin tek autoriteti rregullator i energjisë dhe autoritetet komunale.

Mundësi tjetër të madhe paraqet edhe fakti se, për shkak të pandemisë, korporatat ndërkombëtare po hasin në vështirësi përgjatë zinxhirëve të tyre të furnizimit. Ato janë në kërkim të furnitorëve të rinj dhe njëkohësisht po punojnë në zhvendosjen e linjave të tyre të prodhimit nga Azia në Evropë. Me mekanizma mbështetës të tilla si: stimuj tatimorë, lehtësira doganore, pushime tatimore dhe masa specifike për kompanitë prodhuese, në veçanti eksportuese do të mund të

përkraheshin jo vetëm furnitorët potencialë, por edhe të krijohej stimuj shtesë për tërheqjen e investimeve të huaja direkte (IHD). Për tërheqjen e IHD-së nuk duhet nënvlerësuar potencialin e madh që ka diaspora jonë. Ky potencial, qoftë për të sjellë investitorë, qoftë për ta rritur eksportin e prodhimeve vendore, asnjëherë nuk është shfrytëzuar si duhet.

Përveç krijimit të urave lidhëse dhe qasjes në tregje të huaja, kompanitë prodhuese kanë nevojë për qasje të lehtë në financa me qëllim të rritjes së kapaciteteve të tyre të prodhimit dhe përmbushjes së kërkesave të tregut. Kjo mund të bëhet përmes kredive favorizuese dhe skemave të granteve me kriteret e qarta. Masa konkrete dhe politika të qarta lipsen edhe për sektorët me potencialë, e këtu favorit absolut është ai i teknologjisë informative, që do të mund të çonte tutje digjitalizimin e sektorit publik dhe privat. Në një periudhë afatmesme, një element shumë i rëndësishëm pa të cilin asnjë reformë rrënjësore nuk do të jetë e mundur, është fuqizimi i shkollave profesionale dhe universiteteve, që do të aftësonin kuadro teknike të përgatitura për tregun e ri të punës.

Kosova ngadalë, por në mënyrë të qëndrueshme mund ta ndryshojë strukturën e saj ekonomike dhe të zhvillohet fuqishëm pas recesionit, mirëpo vendimet për këtë duhet të merren tani.

(Ky editorial është pjesë e projektit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) "Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies publike në kohën e pandemisë Covid-19" i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Pikëpamjet e shprehura në këtë shkrim nuk i pasqyrojnë medoemos ato të KFOS-it.)

BQK-ja merr vendim për uljen e përkohshme të tarifave të sigurimit kufitar të autopërgjegjësive

Prishtinë, 29 qershor (ER) - Bordi ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur të mërkurën ka marrë vendim për uljen e përkohshme të sigurimit kufitar të autopërgjegjësive. Ky vendim i marrë nga menaxhmenti i BQK-së ka ardhur pas shqyrtimit të raportit aktuarial të datës 16 korrik 2020 të Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe raportit aktu-

arial të BQK-së mbi adekuatshmërinë e tarifave të sigurimit kufitar nga autopërgjegjësia dhe është vlerësuar se ekziston bazë e mjaftueshme për ndryshimin e tarifave të primeve të sigurimit kufitar të autopërgjegjësive për automjete dhe motoçikleta për udhëtarë.

Me anë të këtij vendimi Banka Qendrore e Republikës së Kosovës kërkon nga Byroja Kosovare e Sigurimeve që në

emër të anëtarëve të saj, siguresve të licencuar për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, t'i ulë përkohësisht tarifën e sigurimit kufitar të autopërgjegjësive për grupet tarifore të autoveturave dhe motoçikletave për 35 për qind.

Po me anë të këtij vendimi kërkohet që aplikimi i tarifave të reja të policave kufitare të zbatohet nga data 1 gusht 2020 deri më 31 dhjetor 2020.



Komisioni Evropian disburson 9.9 milionë euro në buxhetin e Kosovës

Një shumë prej 9.985 milionë eurosh të fondeve të asistencës për mbështetje të buxhetit të dhëna nga Komisioni Evropian janë disbursuar në Thesarin e Kosovës. Këto mjete kanë të bëjnë me standardet lidhur me reformat në administratën publike dhe në menaxhimin e financave publike



makroekonomike të orientuara drejt stabilitetit dhe ta rrisë transparencën, veçanërisht sa i përket shfrytëzimit të

fondeve buxhetore dhe proceseve të prokurimit publik. Kjo mbështetje e BE-së, po ashtu, do ta ndihmojë Kosovën edhe

në luftimin e pandemisë Covid-19 dhe ndikimit të saj në ekonomi dhe financa publike.

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 KORRIK - Një shumë prej 9.985 milionë eurosh të fondeve të asistencës për mbështetje të buxhetit të dhëna nga Komisioni Evropian janë disbursuar në Thesarin e Kosovës. Disbursimet e bëra kanë të bëjnë lidhur me standardet e lidhura me reformat në administratën publike dhe në menaxhimin e financave publike. "Mbështetja e BE-së për reformën e administratës publike dhe menaxhimin e financave publike shpërblen progresin që e bën qeveria në zbatimin e strategjive të saj

dhe në arritjen e synimeve të dakorduara ndërmjet BE-së dhe Qeverisë së Kosovës. BE-ja është duke punuar me Qeverinë e Kosovës në këto reforma që nga dhjetori i vitit 2017", thuhet në një komunikatë të Zyrës së BE-së në Kosovë.

Sipas kësaj komunikate, për ta çuar këtë përpara qeveria tani duhet ta përshpejtojë dinamikën e reformave. Në veçanti, komisioni pret që qeveria të mbetet e përkushtuar për zbatimin e paketës legislative të reformës së administratës publike dhe për hapat e nevojshëm për përmirësimin e llogaridhënies së agjencive të pavarura, t'i vazhdojë politikat

Në gjashtëmujorin e parë shpenzimet u rritën për 38.7 milionë euro

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 KORRIK - Qeveria e Kosovës të mërkurën ka miratuar raportin gjashtëmujor për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020. Raporti përmban një përmbledhje të trendëve kryesorë të të hyrave dhe të shpenzimeve buxhetore për këtë periudhë. Raporti përmban edhe analiza përmbledhëse për këtë periudhë, pasqyron të hyrat sipas institucioneve mbledhëse në nivelin qendror dhe lokal, hollësitë e të hyrave sipas llojit të tatimeve dhe krahasimet me periudhat paraprake dhe me projeksionet buxhetore. Sipas raportit, gjithsej të hyra gjatë gjashtëmujorit të parë të 2020-s ishin në shumën 986.67 milionë euro dhe paraqesin gjithsej 42 për qind të të hyrave të planifikuar, që janë për 8 për qind më të vogla se të hyrat e periudhës së njëjtë të viti paraprak. Shpenzimet e këtij gjashtëmujori ishin në shumën prej 933.73 milionë eurosh, që paraqesin 37 për qind të shpenzimeve të planifikuar. Shpenzimet kanë shënuar rritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar për 38.7 milionë euro. Duhet theksuar se kjo periudhë është krahasuar me ekzekutimin e masave të pakos emergjente të Qeverisë



së Republikës së Kosovës si dhe të shpenzimeve që ndërlidhen me menaxhimin e pandemisë Covid-19.

Raporti do të procedohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës konform Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi. Është miratuar edhe vendimi për hartimin e Programit për Reforma Ekonomike 2021-2023. Ky program do të përgatitet nga Qeveria e Kosovës si pjesë e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për qeverisjen ekonomike. Programi i Reformave Ekonomike bazohet

në kornizën makro-fiskale, prioritetet e reformave strukturore, Programin e Qeverisë 2020-2023 dhe në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021.

Kabineti qeveritar ka miratuar në parim nismën për nënshkrimin e marrëveshjes financiare trepalëshe në mes të Republikës së Kosovës, Bashkimit Evropian dhe Maqedonisë së Veriut për programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shuma e përgjithshme për vitin 2020 në këtë program

është 1 270 589 euro (një milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë). Me vendimin e miratuar në mbledhjen e së mërkurës është vendosur norma e tatimit të akcizës në duhan sipas kalendarit, që fillon nga 48 euro për kilogram që do të zbatohet nga data 1 shtator e këtij viti, ndërsa nga 1 janari i 2021-s do të jetë 49 euro, nga 1 janari i viti 2022 51 euro, nga 1 janari i vitit 2023 do të jetë 53 euro dhe nga 1 janari i viti 2024 55 euro për kilogram. Tri vendime preliminare të shpronësimeve për interes publik të pronave të paluajtshme kanë marrë miratimin e

Qeverisë në mbledhjen e sotme: Pronat që preken nga realizimi i projektit "Themelimi i Qendrës Përkujtimore për Gjenocidin mbi Shqiptarët "Bllaca 1999"; Pronat që preken nga ndërtimi i Rrugës Nacionale Prishtinë-Mitrovicë, Segmenti Gojbulë - Smrekovicë; dhe Pronat që preken nga realizimi i projekteve të Komunës së Drenasit: "Lokacioni për varreza" në Zabel të Ulët; Tregu i Kafshëve në Çikatovë të Re; Zgjerimi i "Zonës Ekonomike në Drenas në Korroticë të Epërme; dhe Ndërtimi i Impiantit të Ujërave të Zeza dhe Industriale të Parkut të Biznesit - Drenas.

Komuna e Skenderajt dhe 'Qatar Charity' do t'i përkrahin me grante 50 familje në nevojë

SKENDERAJ, 29 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me drejtorin e organizatës "Qatar Charity", Mahmoud Abbas Shaker, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për ndarjen e 50 granteve bujqësore për familjet në kushte të rënda ekonomike në vlerë prej 75 mijë eurove. Në kuadër të këtij memorandum, Komuna e Skenderajt, në bashkëpunim me organizatën në fjalë, do të dhurojnë 23 sera bujqësore, 20 shoqëri bletësh, 6 multikultivatorë dhe një kosë, ku si qëllim kryesor është fuqizimi ekonomik i familjeve në nevojë. Kryetari Jashari, pas nënshkrimit të këtij memorandum, është shprehur mirënjohës ndaj organizatës

"Qatar Charity" për bashkëpunimin dhe ndihmën e dhënë, duke bërë me dije se edhe në muajin maj të këtij viti kanë nënshkruar marrëveshje për hapjen e 39 puseve për ujë të pijshëm në Skenderaj. Gjatë këtij takimi, Jashari, së bashku me drejtorin e organizatës "Qatar Charity", Mahmoud Abbas Shaker, kanë biseduar edhe për mundësinë e bashkëpunimit për projekte të tjera jetësore për qytetarët e Komunës së Skenderajt. Ndërsa drejtori Abbas Shaker i ka premtuar kryetarit Jashari bashkëpunim të mëtutjeshëm edhe në fushat e tjera si atë të bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, duke përkrahur me grante të ndryshme qytetarët e Komunës së Skenderajt.



Kryetari i Fushë-Kosovës dhe drejtuesit e KEK-ut bisedojnë për mundësitë e bashkëpunimit



FUSHË-KOSOVË, 29 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berisha, ka pritur në takim Luigj Imerin, ushtrues detyre i kryeshefit ekzekutiv i KEK-ut, i cili shoqërohej nga Edmond Nulleshi, drejtor ekzekutiv i Shërbimeve të Korporatave si dhe Skender Bucolli, drejtor për Marrëdhënie me Publikun. Kryetari Berisha dhe drejtuesit e KEK-ut kanë folur për format dhe mundësitë e bashkëpunimit. "Fokusi i bisedës kryesisht ishte: Projekti i përbashkët për parkun i cili është në procedura të

përbashkëta administrative me ministritë e linjës dhe komunat Fushë-Kosovë, Obiliq dhe Prishtinë. Për këtë projekt, i cili është i financuar nga Banka Botërore e që Qeveria e Kosovës pritet shpejt edhe ta konkretizojë, u morën vesh që procedurat të cilat janë në kompetencë të komunës dhe KEK-ut do të jenë plotësisht të realizueshme. Temë e bisedës ishte edhe realizimi i disa projekteve tjera, duke përfshirë projektet për komunitete, por edhe për mundësinë dhe angazhimin e një grupi prej 100 të rinjve në trajnime për një

periudhë kohore prej tre muajve me mbulimin e shpenzimeve nga ana e KEK-ut. Një nga temat e bisedës ishte edhe furnizimi me ujë të pijshëm në veçanti për banorët e fshatrave Grabovc dhe Bardh i Madh. Të dyja palët u pajtuan se sa iu përket kompetencave të komunës dhe KEK-ut nuk do të ketë asnjë problem, gjë që tani do të shihen mundësitë e Kompanisë Regjionale të Ujësjetës 'Prishtina' se sa do të ketë mundësi t'i kyçë këta dy fshatra në rrjetin e ujësjetës", ka njoftuar komuna e Fushë-Kosovës.

Ndërron jetë punëtori i shërbimeve sociale në Ferizaj, Mërgim Sojeva

Ferizaj, 29 korrik (ER) - Ka ndërruar jetë Mërgim Sojeva, punëtor shumëvjeçar i shërbimeve sociale në Ferizaj. Me këtë rast, kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, përmes telegramit ka ngushëlluar familjen Sojeva, miqtë dhe kolegët e të ndjerit. "Më pikëlloi pa masë lajmi për

ndarjen nga jeta e punonjësit të dalluar të shërbimit social, udhëheqësit të skemës sociale në Qendrën për Punë Sociale, Mërgim Sojeva. I trishtueshëm ky lajm që pllakosi mëzri në mesin e familjes, të njohurve e bashkëpunëtorëve të të ndjerit. Mërgim Sojevën do ta mbajmë

mend gjithmonë si shpresën e më nevojtarëve, punëtorin shembull e prindin e përkushtuar. U prehtë në paqe e dritë pastë shpirti i tij! Ngushëllime familjes, miqve e të njohurve të të ndjerit", është thënë në telegram ngushëllimin e Aliut.



Teatrit "Hadi Shehu" në Gjakovë i shtohen gjashtë aktorë të rinj



GJAKOVË, 29 KORRIK (ER) - Komuna e Gjakovës ka njoftuar se trupës së Teatrit të Qytetit i janë shtuar edhe gjashtë aktorë të rinj. Gjatë ceremonisë zyrtare të nënshkrimit të kontratave të punës, kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, është shprehur i

lumtur për aktorët dhe faktin që ky teatër është duke hedhur një hap të rëndësishëm drejt sukseseve të ardhshme. "Teatri i Qytetit 'Hadi Shehu' është vlerë për Gjakovën, prandaj përkrahjen tonë si institucion komunal do ta keni gjithmonë. Jam shumë i

lumtur për ju, për faktin që munda juaj po shpërblehet. Urime të gjithëve! Shpresojmë që shumë shpejt t'i shijojmë shfaqjet dhe sukseset tuaja të reja. Do të angazhohemi që pjesë e trupës suaj të bëhen edhe aktorë të tjerë", ka thënë Gjini.

PORTRETI E LUFTA E UÇK-SË NUK I KA BORXH NJOLLOSJEJE AS SERBISË E AS NDOJËRIT QË VËRTET ËSHTË I NJOLLOSUR (20)



Shkruan: Kudusi LAMA

“Në periudhën e formimit të UÇK-së, gjatë gjysmës së parë të vitit 1993, në këtë zonë nuk ishte shprehur krimi i organizuar. Me qëllim, para së gjithash, për armatosjen e grupeve të formuara rishtas, pjesëtarët e UÇK-së nga zona e Drenicës dhe e Metohisë, duke u lidhur me kushërinjtë e tyre me punë të përkohshme në Zvicër, Gjermani, Belgjikë, Suedi dhe në vende të tjera, të cilët ishin përfshirë edhe në veprimtari të palejueshme, kishin vendosur shumë kanale për transportimin e armëve dhe të pajisjeve, si dhe të mjeteve financiare për nevojat e terroristëve në Kosovë - Metohi”.¹ Sipas Serbisë, me krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në këto hapësira u themelua krimi i organizuar. Dihet që deklarime të tilla duhen konsideruar banale, por ja që edhe prej atyre si Dick Marty që i beson dhe i vë edhe në raportin që quhet i Këshillit të Evropës. Nga të dyja palët (që, në fakt, janë një), si serbët ashtu edhe Marty arsyetojnë, sipas mendësisë së tyre, se edhe punëtorët shqiptarë nëpër Evropë, me ndihmën e tyre për luftën çlirimtare, ishin përfshirë në veprimtari të palejueshme. Se si mund të jesh i përfshirë në veprimtari të paligjshme nëse angazhohesh për të luftuar në një mënyrë ose tjetër për ta çliruar atdheun nga pushtuesi kjo është e pakuptimtë. “Në bazë të kësaj, ishte arritur një lidhje solide e ndërsjellë e figurave kyçe të terrorizmit shqiptar dhe të bartësve të kimit të organizuar në krahinën tonë në një masë të madhe me diasporën shqiptare të kriminalizuar dhe një pjesë të politizuar, e cila paraqet një faktor shumë të rëndësishëm për funksionimin e lidhjes së kimit dhe të terrorizmit shqiptar”.² Diaspora shqiptare, sipas Serbisë, është një pjesë e kriminalizuar dhe një pjesë e politizuar, por duke qenë shqiptarë për serbët, nuk mund të ketë asnjëri të pastër. Diaspora shqiptare në rrjedhën e veprimtarisë kombëtare ka qenë dhe mbetet në lartësinë e përgjegjësive për çlirimin e atdheut dhe ndërtimin e jetës qytetare në vend, duke financuar dhe marrë përgjegjësi të mëdha në gjithë hapësirën ku është shpërndarë për ta siguruar jetësimin e atdheut dhe çlirimin e

tij. Ajo ka dhënë prova të fuqishme për ta fuqizuar luftën e UÇK-së. E quan Serbia dhe Marty UÇK-në organizatë terroriste apo të kimit të organizuar, ajo mbetet emblemë e krenarisë kombëtare shqiptare. Në portretin e saj nuk ka asnjë njollë. Askush, qoftë edhe zotëri Marty, në emër të Evropës e për interesat e Serbisë nuk mund ta njollosë atë dhe veprën e saj.

“Njëkohësisht, sanksionet që bashkësia ndërkombëtare zbatoi ndaj Republikës Federative të Jugosllavisë, si dhe bllokada tregtare e Republikës së Maqedonisë nga ana e Greqisë, kontribuuan që qysh herët të vendoseshin rrugët e kontrabandës së drogës nga Turqia drejt tregut evropian-perëndimor e orientuar në territorin e Shqipërisë dhe të Kosovës - Metohisë. Një pjesë e të ardhurave që realizuan me këtë punë të paligjshme, bartësit e këtyre veprimtarive i paguan, gjoja, në fondet humanitare, prej të cilave u financuan veprimtaritë e pjesëtarëve të UÇK-së”.³

Serbia gjithnjë ka tentuar ta paraqesë veten si shtet lider në Ballkan, që është e fuqishme ta disiplinonë gjithë rajonin. Këtë edhe e ka propaganduar gjerësisht në gjithë historinë e saj politike. Një dukuri e tillë shihet edhe në citimin e mësipërm, ku u vihet faji sanksioneve të botës kundër Jugosllavisë, që kontribuuan të “vendoseshin rrugët e kontrabandës së drogës nga Turqia drejt tregut evropian-perëndimor e orientuar në territorin e Shqipërisë dhe të Kosovës - Metohisë”. Duket vërtet qesharak ky arsyetim, por ja që ndërtohet në atë mënyrë të stërholluar që në politikën dhe opinionin evropian konsumohet dhe bën efekte duke favorizuar të kundërtën e së vërtetës.

Aspak Serbia edhe sot nuk ka vuarje ndërgjegje për atë që ka bërë mbi popujt e Ballkanit, duke i shkatërruar e duke vuarë me qindra mijëra qytetarë të pafajshëm, por ka shqetësim se bllokada dëmtoi Ballkanin pasi krijoi kushte të favorshme “nga pamundësia e Serbisë për ta ndalur, si rrjedhojë e bllokadës ndërkombëtare”.

Lexuesi duhet të përipiqet të kuptojë domethënien e çdo citimi. Ne duhet të dimë se çfarë thotë armiku për ne. Nëse përipiqemi ta fshehim atë që thotë ai, domethënë ai ka të drejtë, sepse ne trembemi prej atyre thënieve. Nëse vërtetë dikush e ndjen veten fajtor, le të japë llogari, por portreti kombëtar dhe portreti e lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk i ka borxh njollosjeje as Serbisë e as ndonjërit që vërtetë është i

njolllosur. Unë kam dëshirë që ne duke e njohur të vërtetën, të dimë t'i kthejmë përgjigje edhe armikut.

Askush nuk duhet të habitet, armiku kryen punën e tij. Me rëndësi është që edhe ne të kryejmë punën tonë. Në citimet e mësipërme dhe të gjitha ato që do të citohen në këtë kapitull, lexuesit do të arrijnë të kuptojnë se për Serbinë të gjithë shqiptarët kudo që janë, janë mafiozë, kriminelë, terroristë, bashkëpunëtor të kimit, trafikantë, etj., ndërsa shqiptarë të mirë konsiderohen ata të bindurit, ata që nuk e kundërshtojnë pushtimin dhe ata që bashkëpunojnë me pushtuesin. Ndërsa çdo thirrje në emër të atdheut, të kombit, të moralit dhe të drejtësisë që keni dëgjuar deri sot, Serbia e konsideron kriminalitet. Të gjithë ata që kanë këtë mendim, të çfarëdo kombësie qofshin, edhe shqiptarë po të jenë, unë dëshiroj të vihen në frontin e opinionit të Serbisë publikisht, se shqiptarëve në historinë e tyre nuk u prishin punë. Ndoshta do t'i mundojnë, siç do t'i mundojë edhe raporti i Dick Martyt në emër të Evropës me gjykatën speciale që prodhoj dhe vuri në veprim, por në fund fitorja është e shqiptarëve të ndershëm dhe e luftëtarëve të UÇK-së.

“Nga pothuaj 900 milionë DEM (marka gjermane) që arritën në Kosovë e Metohi ndërmjet viteve 1996 dhe 1999, gjysmën e përbënin paratë e fituara me tregtinë e narkotikëve, që specialistët e Interpolit në dhjetor të vitit 2000, i çuan në përfundimin se janë veprimtari të mjeteve të mbledhura për Kosovën dhe UÇK-në të përdorura për pastrimin ilegalisht të parave të fituara”.⁴

Unë nuk kam pritur që Serbia të shprehet ndryshe. Nëse do të shprehej ndryshe do të dilte vetja. Por shqiptarët që i kanë dhënë ato të ardhura financiare për luftën e tyre për liri, e dinë mirë se me sa mund e djersë i kanë fituar ato para, duke punuar pa orar që të financojnë familjet në varfëri të tejkajshme dhe të japin kontributin e mundshëm për çlirimin nga pushtuesi.

Të gjithë besoj e kujtojnë edhe vendimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për mobilizimin e përgjithshëm, ku përjashtoheshin nga mobilizimi të gjithë ata që me punën e tyre në Evropën Perëndimore e në Amerikë, kishin mundësi të financoni sado pak që luftëtarët të mund të vazhdonin kryerjen e detyrave luftarake kundër pushtuesit. Po të kishte para të mjaftueshme e të bollshme siç pretendon Serbia në deklaratimet e

saj, nuk kishte nevojë të shmangeshin kjo kategori e shqiptarëve nga mobilizimi për të qenë luftëtarë në frontet e lirisë në atdhe.

Pra, duhet kuptuar se edhe ata që kanë financuar Luftën Çlirimtare të Kosovës, kanë dhënë kontributin e tyre shumë të madh për lirinë. Por asnjë prej tyre nuk ka menduar të fitojë në rrugë të paligjshme për të financuar luftën.

Edhe Europa në vitin 1998 duke dëgjuar shpifjet serbe bëri një bllokim të përkohshëm të këtyre fondeve, por kur vërtetoi se ato nuk ishin tjetër veçse para të qytetarëve të emigruar që i fitonin me punën e tyre të ndershme në vendet e Evropës dhe që i financonin për lirinë e vendit të tyre, ky bllokim u hoq dhe financimi vazhdoi normalisht.

“Kanalet për transportim ilegal të drogës, UÇK nuk i ka shfrytëzuar vetëm si mënyrë që heroina të transportohej në Evropë, për shkak të fitimit (profitit) të madh, por edhe për shkak të futjes së armëve në Ballkan. Droga është këmbëdrejtë e me armë ose ato janë blerë me para të fituara nga tregtia e narkomanëve në Shqipëri, Bosnjë - Hercegovinë, Kroaci, në Qipro, Itali, Mal të Zi, Zvicër dhe në Turqi”.⁵

Sipas citimit të mësipërm gjithkush duhet të kuptojë se sipas propagandës shpifëse të Serbisë, çdo armë që ka ardhur në Kosovë për të luftuar me të për çlirimin e vendit nga pushtuesi, është blerë me paratë e drogës dhe të trafikut të saj. E për këtë nuk përtohet të njollosen jo vetëm shqiptarët, por edhe Bosnje - Hercegovina, Kroacia, Qiproja, Italia, Mali i Zi, Zvicra dhe Turqia. Nuk janë vetëm këto shtete që konsiderohen se ishin në lojën e shqiptarëve për trafikun e Drogës. Në citimet e mëposhtme do të shikoni se nuk kursehet as Franca, Anglia, Gjermania, Kanadaja e edhe ShBA-ja. Por këto nuk janë befasi, ne jemi mësuar me shpifje të tilla. Problemi qëndron në atë se si t'u bëhet e qartë Dick Martëve se këto janë mashtrime. Rruga e sqarimit të këtyre të pavërtetave që ua veshin serbët të gjithëve, por për hatër të shqiptarëve ose nën diktatin e tyre, që këtë nuk besoj se e pranojnë gjermanët, francezët, anglezët, italianët, grekët, turqit, skandinavët, amerikanët etj., që të jenë nën diktatin e shqiptarëve e të bëjnë çfarë duan shqiptarët.

Unë jam i sigurt jo sipas bindjeve, por duke e parë dhe njohur gjendjen në vendin dhe në kohën ku dhe kur ka ndodhur, se çdo armë e futur dhe përdorur në Luftën Çlirimtare të Kosovës nga

UÇK-ja, është blerë me paratë e mundit dhe të djersës së shqiptarëve në atdhe dhe në vendet e tjera, si dhe luftëtarët asnjëherë nuk kanë kërkuar far luks për vetë përveç elementëve më minimal për jetesë. Dhe kur them luftëtarët, nuk kam parasysh ushtarët e thjeshtë të frontit, por nga Komandanti i Përgjithshëm e UÇK-së, anëtarët dhe funksionarët e Shtabit të Përgjithshëm e në gjithë hierarkinë e kësaj lufte, që unë për fatin dhe lumturinë time i kam njohur dhe ua di bëmat dhe jetesën e asaj kohe të lavdishme, për të cilën ata vetë por edhe çdo shqiptar duhet të ndihet krenarë. “Me ardhjen e forcave ndërkombëtare në Kosovë - Metohi u krye dezintegrimi dhe çmilitarizimi formal i UÇK-së, por kjo organizatë as deri më sot nuk e ka ndërprerë veprimtarinë e vet. Një pjesë e përbërjes e ka orientuar veprimtarinë në plan politik, nëpërmjet partive: Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ndërsa rreth 10.000 pjesëtarë të UÇK-së janë përfshirë me transformimin e UÇK-së në Korpusin e Mbrojtjes së Kosovës dhe në Shërbimin e Policisë së Kosovës”.⁶

Çfarë mendon Serbia në këtë libër të 2004 dhe Dick Marty me raportin e vitit 2010, a mos kanë menduar se çlirimtarët, pasi të çlirohej atdheu do ta braktisnin atë? Natyrisht pas lufte luftëtarët ingranohen në parti politike, në polici të vendit, në forcat ushtarake dhe në administratën civile. Pse Serbia dhe zotëri Marty mendojnë se pas lufte ata nuk duhet të ishin askund. Pse mendojnë se duhet të ishin jashtë Kosovës ose të mos kishin asnjë të drejtë? A e kuptojnë pse luftohet për liri Serbia e zotëri Marty? Realisht kur lexon deklaratime të tilla ata që i kanë shkruar duket se janë shakaxhinj, por që bëjnë siç thonë shqiptarët: Shaka pa kripë.

(Vijon)

⁸ Po aty faqe 10

⁹ Obilić, Millosh, “Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 11, botimi serbisht

¹ Obilić, Millosh, “Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 9, botimi serbisht

² Po aty faqe 9

³ Obilić, Millosh, “Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 9, botimi serbisht

⁴ Obilić, Millosh, “Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 9-10, botimi serbisht

⁵ Obilić, Millosh, “Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 10, botimi serbisht

⁶ Po aty faqe 10

Ton Koka, shqiptari i CIA-s që zbulonte agjentët e UDB-së dhe KGB-së në Evropë



Nga: Ardian NDRECA

Kohët e fundit emni i Ernest Koliqit asht përfolë shumë, madje tue shkue deri atje sa me hamendësue një lidhje të tij me KGB-në. Hipotezat pa bazë nuk meritojnë asnjë përgjegje, prandaj ky shkrim ka si qëllim thjesht me hjedhë dritë mbi një moment të caktuem të jetës së Koliqit në mërgim, kur ai ishte vu në shën-jestrën e KGB-së.

Rrëfimi i këtij episodi i përket historisë së bashkëpunimit prej ma se katër dekadash të agjentit shqiptar ma të suksesshëm në CIA, Ton Kokës, një njeriu që kaloi të gjitha etapat e karrierës nga përkthyes, në analist, gjurmues dhe në fund rekrutues në shumë qytete të Europës.

Kam pasë fatin t'i gëzohem për shumë vite miqsisë së Ton Kokës, një patriot i vërtetë që shpenzoi jetën e tij tue punue për Agjencinë e Langley-t kundër regjimit të Tiranës dhe atij të Beogradit, kundër Brigadave të Kuqe në Itali dhe KGB-së.

Ton Koka ka disa datëlindje, por në të vërtetë ka lindë në Cetinë më 26 prill 1917 në familjen e një tregtari shirokas që lëvizte nga Venediku në Shkodër e Cetinë; ka vdekë në moshën 97-vjeçare në Trieste. I mbetun në Itali qysh prej kohës së luftës, Koka, nshanës i At Gjergj Fishtës në liceun Illyricum, siç i pëlqente me u përkufizue, nisi me bashkëpunue në Triesten e pushtueme prej trupave të Titos me Counter Intelligence Corps (CIC), Shërbimin e Inteligjencës së ushtrisë amerikane gjatë Luftës së Dytë Botnore, i cili ishte pararendës i CIA-s. Si atëherë ashtu edhe ma vonë kur vijoi me punue për CIA-n, ai dha një kon-tribut të randësishëm në zbulim-

in e shumë agjentave të Tiranës që asokohe vepronin në Trieste për llogari të UDB-së, por edhe anekand Europës, mbërrijti me nxjerrë të holla prej Shqipnije me të cilat CIA pajiste parashutistat që hidhte në malet e vendit tonë, me krijue kontakte me njerëz në atdhe dhe me mundësue kalimin në Perëndim të personave, informacioneve dhe provave të krimeve të regjimit enverist.

Për bashkëpunimin nëpërmjet tij me shërbimin amerikan të CIC, besoj se një ditë do të përmenden me nderim shumë njerëz deri më sot krejt të panjohun, siç asht për shembull Mehmet Kotorri, kapiteni i anijes "Rozafa", dhe Asllan Begu i anijes "Teuta", që në fundin e viteve '40 përshkonin rrugën detare Durrës-Trieste, apo trimi i urtë shkodran Haxhi Sulë Smajli që me shumë guxim ndihmoi kauzën antikomuniste të amerikanëve.

Ma vonë Ton Kokën e gjejmë në Romë, Athinë, Vjenë, Uashington, Beograd, Milano. Për dekada Mr. Carlson, siç njihet në detyrë, mori në pyetje shumicën e shqiptarëve të arratisun që paraqisnin ndonji farë interesi për CIA-n: ushtarakë, nëpunës, agjenta të Sigurimit, fshatarë, funksionarë. Mbërriti edhe me rekrutue disa agjenta të kundërzbulimit shqiptar që nuk do të diktoheshin kurrë prej regjimit të Tiranës si dhe organizoi një rrjet përgjimi në disa ambasada shqiptare prej ku Agjencia mësonite komunikimet sekrete me Tiranën dhe të dhana tjera me randësi, si p.sh. vendbanimet e informatorëve të Sigurimit në Europë, të cilët digjeshin sistematisht dhe detyroheshin të jepnin informata të gabueme.

Por këtu po ndalemi vetëm te një operacion i drejtue prej tij që kishte për qëllim zbulimin dhe

demaskimin e një agjenti të KGB-së në Romë, i cili kishte fitue besimin e Ernest Koliqit dhe rrezikonte pozicionin e këtij të fundit. Ngjarja rrëfhet nga vetë Ton Koka në kujtimet e tija në dorëshkrim të cilat shpejt do të shohin dritën e botimit. CIA kishte frikë nga një ekspozim i mundshëm i Koliqit, mbasi ai ishte në dijeni të planeve me randësi si dhe mbante asokohe në shtëpi korrespondencën private me shumë personalitete, me zyrtarë të CIA-s, të Intelligence Service, me autoritete italiane, me mërgimtarë politikë etj.

Vetë Koliqi e kishte të qartë se ambasadat e Tiranës, Beogradit dhe Moskës tregonin shumë interes për veprimtarinë e tij në Romë dhe sidomos atë të Shejzave që ai drejtonte. Pranë Librisë Ndërkombëtare Rizzoli, këto tri ambasada porositnin rregullisht një numër të konsiderueshëm revistash.

Në vitin 1969 Ton Koka, asokohe agjent me shërbim në Romë në një kohë kur Shef Stacioni ishte Seymour Russell, për shkak të frekuentimit vllaznor që kishte me Koliqin, vëren afrimin e papritun me këtë të fundit të një figure të re, krejtisht të panjohun. Bahej fjalë për njëfarë Angelo de Genti, figurë misterioze i ardhun prej hiçit për të cilin dihej shumë pak. Dihej për shembull se i jati, sicilian, me pushtimin e Shqipnisë ishte shpërngulë për një jetesë ma të mirë në Tiranë tue punue si mekanik. Me fundin e Luftës gjurmët e Angelo de Gentit humbnin, por kishte dyshime – rrëfen Koka – se në vitet '50 nëpërmjet Ambasadës Sovjetike në Tiranë ishte transferue në Moskë.

Angelo de Genti vetë pohonte se kishte përfundue studimet në BRSS dhe në vitin 1969 ishte

kthye në Romë. Stacioni i CIA-s në Romë mëson pa vonesë se KGB-ja i kishte marrë një dhomë me qira në Via Cola di Rienzo, n. 4. Ndërkaq De Genti kishte marrë me qira edhe një banesë tjetër në një fshat në veri të Romës, në Sutri, ku zhvillonte takime edhe me disa shqiptarë. Banesa në Sutri përdorej gjoja për me i dhanë lehtësime për me përkthye italisht Dostojevskin për një skenar filmi, për përgatitjen e të cilit kishte pasë një ofertë nga ana e RAI-t.

Koka alarmohet menjherë, pse tue qenë i lauruem në Shkenca Politike në Trieste dhe tue e njohët mirë letërsinë dhe gjuhën ruse, që e kishte studjue në kurse speciale në Uashington, e dinte mirë se Dostojevski ishte i përkthym mjeshtrosh në gjuhën italiane. Ndërkaq merr vesh edhe mënyrën sesi De Genti i ishte afrue Koliqit nëpërmjet kunatit të këtij të fundit, Petro Vuçanit, të cilit madje i kishte dhurue edhe një samovar të punueme në mënyrë artistike për Koliqin, tue i lanë me kuptue se e kishte kalue pa doganë në Itali. S'vonon dhe Angelo de Genti bahet si i shtëpisë te Koliqi, i cili i boton edhe një përkthim nga rusishtja te Shejzat.

Koka mbërrin me u njohët me Angelo de Gentin dhe meqë ky i fundit kishte mangësi dhe nuk zotnonte një italisht të denjë për me përkthye Dostojevskin, i ofron ndihmën e tij në përkthim. Dy herë në javë Ton Koka ndihmon, me dijeninë e plotë të eprorëve të tij, përkthimin e De Gentit në Sutri. Ndërkaq CIA ka vendosë në përgjim telefonin e agjentit sovjetik dhe e ndjek atë hap mbas hapi. Vërehet menjherë se De Genti fliste dy-tri herë në javë me një vajzë në Moskë që quhej

Ludmilla. Mbas pak kohësh Ludmilla mbërrin në Romë. Ton Koka në kujtimet e tija e përshkruen: "20-vjeçare, e pashme, bionde, e naltë dhe me një veshje qi bjen në sy. Një mini një dy gisht nën mbrapanicë, një këmbë si arkate me qitë në pah pasunitë e gjoksit të dukshëm."

Siç duket, KGB-ja kishte llogaritë gjithçka, tue përfshi edhe shijet estetike të profesorit shqiptar, por s'kishte llogaritë pasionin me të cilin Koka kryente detyrën e tij, tue gjurmue çdo rrezik që mund t'i vinte mikut të tij shkodran. Vajza ruse paraqitet si bashkëshortja e De Gentit dhe kishte si mburojë për veprimtarinë e saj artin, në fakt ajo ishte balerinë dhe udhtonte në të gjithë Europën, por edhe në Algjeri dhe në Marok. Cilësitë fizike i lejojnë asaj me afrue këdo që kishte sadopak tërheqje natyrale ndaj një femne të hijshme. Ndërkaq Angelo ishte ba si i shtëpisë te Koliqi, aq sa CIA nisi me pa mundësinë e një ndërhyrjes së shpejtë për me neutralizue rrezikun.

Pa shkue shumë kohë Ton Koka nis me e provokue dhe me e përpunue Angelon i cili për shkak të presionit dhe tue e pa veten të izoluem nga Ambasada Sovjetike jep shenja dobësie. Në një moment ai, i lodhun i tregon Kokës se dikush në Moskë asht i interesuem për me dijtë se çka ban Koliqi dhe Camaj në Romë, sidomos çka synojnë ata me veprimtarinë e Shejzave. Një natë vonë, ndërsa Ton Koka përcjell Angelon me makinë te shtëpia e këtij në Via Cola Rienzo, vëren se te dera e banesës po priste në kambë agjenti i KGB-së, Petrov, figurë e njohun që i përkiste stacionit të Villa Abimelek në Romë. Edhe pse në kushte jo të favorshme, Koka e fotografon me një aparat të vogël që e mbante të maskuem në kravatë dhe të nesërmen së bashku me kolegët sigurohet për identitetin e agjentit sovjetik. Angelo de Genti tashma ishte djegë dhe Agjencia cakton pikërisht Ton Kokën me e marrë në pyetje. Angelo nuk mund të shmanget dhe nis e tregon emnat që njeh dhe kontaktet që ka, ndër ta ka edhe emna shqiptarësh që Koka s'i mendonte kurrë se mund të punonin për KGB-në në Itali. CIA, përfundon rrëfimin e tij Ton Koka, mbërrijti kështu me i shmangë një rrezik real Ernest Koliqit dhe njëkohsisht me kuptue lidhjet e celulës së KGB-së në Romë, ndërsa ndaj vetë Angelo de Genti u tregue "zemërgjanë" tue mos e kthye në BRSS ku me siguri e priste Siberia. Herën e fundit në publik, shikimi im, shkruen Ton Koka, u kryqzue prej larg me atë të Angelo de Gentit, ditën e funeralit të Ernest Koliqit në Piazza della Balduina, tek rrinte në një kand i vetmuem./Telegrafi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E jashtëzakonshme

Ariu futet në oborrin e një familje dhe relaksohet në pishinën e fëmijëve



Një grua nga Virxhinia është surprizuar kur ka parë një ari gjigant duke u relaksuar në pishinën e fëmijëve në shtëpinë e saj. Nuk është hera e parë që Regina Keller ka parë kafshë të egra në oborrin e shtëpisë, por një ari në pishinën e fëmijëve ishte një ngjarje që e ka kënaqur dhe e ka bërë për të qeshur. Oborrin e shtëpisë së saj e kanë vizituar dre, arinj, dhelpra dhe ketra.

BARSOLETA E DITËS



- Petrit, jam çmendur pas teje.
- Atëherë rri afër babait tim.
- Pse?
- Sepse është drejtor i Spitalit Psikiatrik.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

E rrallë

Familja e vajtoi dhe i bëri funeralin, katër muaj më pas e gjejnë duke shëtitur në varreza

Ata e besuan se kishte vdekur. Katër muaj më parë familja gjithashtu kishte organizuar një funeral për të, por ai është gjallë dhe u gjet duke bredhur në një varrezë të fshatit Kafr Al-Hosar, në periferi të Kajros (Egjipt). Kjo është historia e jashtëzakonshme e Mohamed El-Gammal, një ish-mësues 40-vjeçar i cili vuan nga një çrregullim mendor. Familja u shokua kur mësoi se kishin varrosur personin e gabuar.

FOTO E DITES



Disa djem në Pakistan mbulojnë kokën me qese najloni për t'u mbrojtur nga shiu. /AP/



DASHI
Gjërat mund të duken

sikur po lëvizin më shpejt nga sa do të dëshironit, gjë që mund të shkaktojë një farë nervozizmi te ju.



DEMI
Mos u shqetësoni nëse nuk mund të

dilni nga shtrati ose nëse ideja e të veshurit duket si një mal i pakapërcyeshëm. Sapo të dilni jashtë do ta shijoni në maksimum.



BINJAKËT
A mendoni se dikush nuk është

plotësisht i sinqertë me ju tani? Bëjani të qartë këtij miku, shoku ose thjesht një të njohuri se kërkon korektesë në marrëdhënien tuaj.



GAFORRJA
Lajmet e mira në mëngjes do t'ju

stimulojnë mendjen tuaj duke ju lejuar të dilni me plane shumë të ndryshme për atë që doni të bëni me ditën tuaj. Jo çdo gjë do të realizohet.



LUANI
Nëse ndjeni tensionin tuaj të

gjakut në rritje, ju duhet të bëni më shumë se thjesht të merrni frymë thellë. Ka ardhur koha t'i trajtoni problemet me një mënyrë tjetër, pra të përballeni me ato.



VIRGJËRESHA
Për një pasqyrë të veçantë për

problemët tuaja më të fundit, drejtohuni te një prej miqve tuaj. Duhet të konsultoheni me dikë që është në të njëjtën situatë si ju.



PESHORJA
Është koha që të keni një bisedë të drejtpërdrejtë

me një person që e pëlqeni. Ndoshta përgjigjet që do të merrni nuk do të sqarojnë asgjë për ju, por kjo nuk është e rëndësishme.



AKREPI
Nëse rutina juaj po fillon të jetë e

mërzitshme, rezistoni dëshirës për të krijuar një problem vetëm për hir të të pasurit diçka për të cilën mund të flisni.



SHIGJETARI
Nëse jeni duke punuar për

të forcuar ose mbështetur një romancë nesër, atëherë çojeni deri në fund synimin tuaj.



BRICJAPI
Filloni provoni gjëra të reja.

Monotonia ju ka vrarë dhe ju ka bërë më agresiv. Ju nuk e kuptoni, por të tjerët rreth jush e kanë kuptuar.



UJORI
Mos u habitni nëse takoni një

person interesant. Ai mund ta stimulojë mendjen tuaj dhe ta angazhojë zemrën tuaj në një nivel më të lartë dhe më të ri.



PESHQIT
Njerëzit do t'u përgjigjen shumë më mirë

shembujve konkretë sesa koncepteve të dykuptimta sot, kështu që nëse përpiqesh të nxjerrësh në pah një ide, do të duhet ta bësh me fakte.


Madonna censurohet nga “Instagrami” për përhapje të dezinformatave rreth Covid-19



Mbretrësja e muzikës pop, Madonna, së fundi publikoi një video e cila fliste rreth koronavirusit. Videoja me teori konspirative për Covid-19 bëri që këngëtarja të censurohet nga “Instagrami” ngaqë u vlerësua se kishte informacion të rremë. Përmbajtja e asaj videoje ishte e tillë që thoshte se vaksina për ta luftuar

koronavirusin është gjetur, por po fshihet me qëllim që t'i lejojë të pasurit, të pasurohen më shumë. “Instagrami” e fshiu atë video nga profili i Madonnës këtë video ngaqë vlerësoi se ishte dezinformatë dhe se kishte pranuar reagime të panumërtë nga ndjekësit. Më herët Madonna kishte deklaruar se e kishte pasur koronavirusin.

Fotografi të papublikuara nga pushimet e Duas me të dashurin në St. Lucia



Pas disa muajsh qëndrimi e vetizoluar në Londër bashkë me partnerin, Anwar Hadid, Dua Lipa kishte shijuar disa ditë pushimi në St. Lucia. Këngëtarja shijoi në maksimum ato ditë pushimi dhe më pas udhëtuan drejt fermës së prindërve të Anwarit në Pensilvani. Së fundi, Dua

postoi disa fotografi të reja në “Instagram” nga pushimet, në të cilat shfaqet e lumtur krah Anwarit dhe shfaq fizikun në bikini. Dua Lipa së fundi ka qenë emër shumë i komentuar pas postimeve që bëri lidhur me kërkesën drejtuar kompanisë “Apple” për vendosjen e Kosovës në hartë.



Rita Ora fotografohet për herë të parë në publik me të dashurin 10 vjet më të vjetër

Rita Ora është padyshim një ndër këngëtarët më të suksesshme me famë botërore. Shqiptarja ka qenë gjithmonë në fokus të mediave, së fundmi për shkak të lidhjes së re të dashurisë. Mediat e huaja kanë publikuar disa fotografi të 29-vjeçares me part-

nerin 39-vjeçar, Roman Gavras. Çifti po kthehej në shtëpi pas festës së mikeshës së Ritës, Anda Vlasaku, e cila festonte 30-vjetorin e lindjes. Rita shfaqet e veshur me një stil të veçantë të viteve '70, kombinuar me xhinse të gjera dhe një këmishë ekstravagante.

Georgina Rodriguez, një nënë shembullore



Edashura e Cristiano Ronaldos, Georgina Rodriguez, ka vendosur të ndajë edhe disa fotografi të tjera ndërsa shihet së bashku me familjen e saj. 26-vjeçarja është parë e veshur me bikini, ndërsa pranë saj qëndronin futbollisti i njohur dhe katër fëmijët.

Georgina është shfaqur më e lumtur në krah të pjesëtarëve të familjes. Në fotot e publikuara shihet qartë kujdesi që ajo tregon ndaj të miturve, edhe pse 3 prej tyre nuk janë fëmijët e saj biologjikë. Ronaldo dhe Georgina po paguajnë 33 mijë euro qira në javë për të qëndruar në jaht.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Prishtina fiton Kupën dhe siguron daljen në Evropë

Prishtina e ka fituar Kupën për herë të shtatë në historinë e saj, pasi në finale e ka mposhtur Ballkanin me rezultat 1-0. Prishtina është skuadra e dytë që do ta përfaqësojë Kosovën në garat parakualifikuese të Ligës së Evropës, pas Gjilanit. Ndërsa në Ligën e Kampionëve merr pjesë skuadra e Dritës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 KORRIK - Skuadra e Prishtinës është fituese e Digitalb Kupës së Kosovës në futboll, pasi në finalen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" e ka mposhtur Ballkanin (1-0). Skuadra kryeqytetase e ka fituar Kupën për herë të shtatë në historinë e saj dhe me këtë rast e ka siguruar pjesëmarrjen në garat parakualifikuese të Ligës së Evropës.

Në minutën e 20 Diar Miftaraj asiston për Oto John, i cili realizon golin e parë. Në minutat në vazhdim, Ballkani u përpoq ta barazojë rezultatin por, pa sukses. Në anën tjetër Prishtina në fund të pjesës së parë lëshoi edhe një rast të mirë, kur Meriton Korenica nuk

Fituesit e Kupës

1992 - Trepça
1993 - Flamurtari
1994 - Prishtina
1995 - Liria
1996 - Flamurtari
1997 - 2 Korriku
1998 nuk është zhvilluar (gjendje lufte)
1999 nuk është zhvilluar (gjendje lufte)
2000 - Gjilani
2001 - Drita
2002 - Besiana
2003 - KEK
2004 - Kosova (Prishtinë)
2005 - Besa
2006 - Prishtina
2007 - Liria
2008 - Vëllaznimi
2009 - Hysi
2010 - Liria
2011 - Besa
2012 - Trepça '89
2013 - Prishtina
2014 - Feronikeli
2015 - Feronikeli
2016 - Prishtina
2017 - Besa
2018 - Prishtina
2019 - Feronikeli
2020 - Prishtina



arriti ta dërgojë topin në portën e skuadrës suharekase. Në pjesën e dytë rastet nuk munguan, por gola të tjerë nuk pati. Topalli, Krasniqi dhe Daku nuk arritën ta barazojnë rezultatin, derisa në minutën e 80 Liridon Fetahaj shënoi gol, por gjyqtarët e anuluan për shkak të pozitës jashtë loje.

Edhe Prishtina pati raste shënimi, por që nuk u konkretizuan në gol. Prishtina pas dështimit në garën për titull arriti ta fitojë Kupën dhe tash do të marrë pjesë në garat e Ligës së Evropës, kurse Ballkani ishte ndër skuadrat më të mira gjatë gjithë kampionatit, por edicionin 2019/2020 e mbylli pa asnjë trofe.

SHKURT

Dautaj, pas largimit nga Besa: Suksese në Superligë

Anësori i njohur në futbollin e Kosovës, Qëndrim Dautaj, i ka dhënë fund aventurës te skuadra e Besës së Pejës. Dautaj i ka uruar suksese në Superligë Besës, e cila është inkuadruar pas mbylljes së kampionatit 2019/20 në Ligën e Parë. "Kemi mbyllur bashkëpunimin me Klubin e FC Besës. Falënderoj pronarin e ri të klubit i cili është treguar shumë korrekt sa i përket borxhit që na ka pasur klubi. Suksese në Superligë", ka shkruar Dautaj në profilin e vet në "Facebook".

Leicesteri interesohet për Muriqin

Skuadra e Leicester Cityt është duke u interesuar për sulmuesin e Fenerbahçes, Vedat Muriqi. Për sulmuesin shtatlartë interesim kanë shprehur edhe disa skuadra të tjera në Angli dhe Itali. 26-vjeçari me skuadrën turke ka kontratë deri në qershor të vitit 2023. Në të gjitha garat e edicionit 2019/2020, Muriqi ka shënuar 17 gola dhe ka kontribuar me shtatë asistime. Ai më herët karrierë ka bërë edhe te disa skuadra në Turqi dhe Shqipëri, kurse në Kosovë ka luajtur për Lirinë e Prizrenit.

Bekaj, mes Turqisë dhe Gjermanisë

Portieri i Prishtinës dhe Përfaqësueses së Kosovës, Visar Bekaj, mund të la Superligën e Kosovës në afatin kalimtar të verës. Gardiani prishtinas mund ta vazhdojë karrierën në Gjermani apo Turqi. Mediat e njohura turke si "Fanatik" apo "Haberler" kanë shkruar. "Bekaj, 23-vjeçari që luan me Prishtinën në Kosovë, mund të jetë e ardhmja e re në kampionatin turk". "Ai më parë ishte në shënjestër të Beshiktashit, por ka mundësi të shkojë edhe në Gjermani te Hoffenheimi apo Hamburgu", shkruhet në gazetën turke. Bekaj ishte pranë kalimit në futbollin gjerman edhe në afatin kalimtar të verës së kaluar, mirëpo operacioni dështoi të realizohet në fund. Edhe pse shumë i ri, Bekaj ka qenë mes futbollistëve kryesorë të Prishtinës në vitet e fundit. Mbetet të shihet nëse ai do të mund ta bëjë hapin e karrierës në këtë afat kalimtar.

Rashica: Ëndrra jonë është kualifikimi në Evropian

Futbollisti i Kosovës, Milot Rashica, ekskluzivisht në emisionin "Ndërimi i natës" në Klan Kosova ka folur për ëndrrën që e kanë lojtarët e Kosovës. Rashica ka thënë se kualifikimi mbetet i vështirë, por beson se kjo do të bëhet realitet. "Kjo është jashtëzakonisht e madhe për tifozët, për shtetin. Është ëndërr edhe për lojtarët që të kualifikohemi në një kompeticion të madh. Vullneti dhe dëshira është shumë e madhe. Atmosfera është shumë e mirë dhe kjo është ajo që na jep vullnet dhe motiv", ka thënë Rashica.

Ylli i Werder Bremenit theksoi se kundërshtarët nuk duhet të nënvlerësohen asnjëherë. "Presion ka kapak, por edhe kundërshtari nuk duhet të nënvlerësohet se kanë bërë ndeshje shumë të mirë. Kjo është ëndrra jonë, por është e çdo tifozit të Kosovës që të marrë pjesë në Kampionatin Evropian", ka shtuar Rashica.

Llapi prezanton dy transferime 'bombë'

PODUJEVË, 29 KORRIK (ER) - Skuadra e Llapit ka bërë dy transferime të mërkurën për edicionin e ri futbollistik. Bëhet fjalë për portierin Loris Kikkri. 23-vjeçari është nga Italia dhe karrierën futbollis-

tike e ka filluar në te Perugia Calcio AC 1905. Së fundmi, ai ishte pjesë e skuadrës, Orvietana Calcio. Klubet në të cilat ka bërë karrierë Kikkri janë Villabaggio, Sansepolcro, Citta Castello, Bastia, Ellera

dhe Orvietana Calcio. Transferimi i dytë që e ka realizuar skuadra e Tahir Batatinës është Eglentin Gjoni. Qendërmbrojtësi i gjatë 1.94 m përforcon edhe më tepër repartin defanziv. Gjoni vjen

në skuadrën e Llapit nga Kategoria Superiore, i cili në edicionin e fundit mbrojti ngjyrat e KF Laçit. Të dy transferimet e reja kanë nënshkruar marrëveshje njëvjeçare me skuadrën e Llapit.



Bunjaku: Liga Kosovë - Shqipëri në favor të basketbollistëve të rinj

PRISHTINË, 29 KORRIK - Edicioni i ri në basketbollin e Kosovës pritet të nisë me risi, pasi do të fillojë edhe liga e përbashkët në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Federata e Basketbollit e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë janë duke punuar intensivisht për jetësimin e ëndrës për një ligë të përbashkët, ku do të marrin pjesë katër skuadrat më të mira të Kosovës dhe katër më të mirat nga Shqipëria.

Kjo ide po përkrahët nga

komuniteti i basketbollit në Kosovë, si trajnerët, analistët dhe lojtarët. Basketbollisti i Kosovës dhe Golden Eagle Yllit, Valon Bunjaku, thotë se kjo do të jetë një risi dhe në favor të lojtarëve të rinj. "Liga e përbashkët Kosovë - Shqipëri mendoj se do të jetë një risi për ne basketbollistët, po ashtu edhe për shikuesit. Gjithashtu, do të jetë në favor të basketbollistëve sepse do të ketë shumë lojërë. Qëllimi kryesor i kësaj lige është përkrahja e

basketbollistëve të rinj. Skuadrat duhet t'u japin më shumë hapësirë të rinjve, që do të ishte një motivim i madh për ta sepse në vendin tonë ka shumë talentë të rinj që meritojnë përkrahje, e kjo do të kishte ndikim shumë të madh në fushën e basketbollit. Jam shumë i lumtur që erdhi një bashkëpunim i tillë dhe mendoj se do të jetë një përvojë prej më të mirave", është shprehur Bunjaku për faqen zyrtare të FBK-së.



Reali rikonfirmohet klubi më i vlefshëm në botë

MADRID, 29 KORRIK - Real Madridi vazhdon të jetë klubi më i vlefshëm i futbollit në botë sipas raportit të fundit të përgatitur nga "Brand Finance". Në një kontekst të rënimit ekonomik dhe social, të shkaktuar kryesisht nga pandemia e Covid-19, vlera e Real Madridit si markë është ulur 13,8 %, në 1 419 milionë euro, por gjithsesi e ruajti pozicionin si më e madhja.

Klubi i bardhë, mjaft i fortë në industrinë e futbollit, ndiqet nga afër prej Barcelonës, që i rrëmben vendin e dytë Manchester Unitedit. "Sot dy marka spanjolle në botën e futbollit janë kryesuese. Sporti spanjoll është padyshim krenaria jonë, tregon fuqinë e kombit tonë", ka thënë Teresa de Lemus, drejtoreshë menaxhuese e "Brand Finance". Pavarësisht se ka humbur këtë vit 13,8 % të vlerës së markës së tij, e cila tani është 1 419 milionë



euro, Real Madridi është akoma marka më e fuqishme në futbollin botëror dhe rezultatet tregojnë se e ardhmja do të jetë më e mirë, duke qenë se fitoi titullin e La Ligas këtë vit. "Los Blancos" e ka zgjeruar ofertën tregtare duke lansuar një markë inovacioni, "Real Madrid Next", qëllimi i së cilës është të punuarit me ndërmarrje fillestare të orientuara nga teknologjia.

Real Madridi, gjithashtu, po përfiton mirë nga rritet sociale për ta rritur pjesëmarrjen e ndjekësve të tij. Në "top-dhjetëshe" renditen: Real Madrid (Spanjë), FC Barcelona (Spanjë), Manchester United (Angli), Liverpool (Angli), Manchester City (Angli), Bayern Munich (Gjermani), PSG (Francë), Chelsea (Angli), Tottenham Hotspur (Angli), Arsenal (Angli).

SHKURT

Tare e dëshiron Silvan në Lazio

Igli Tare ka nisur merkaton pa u mbyllur ende ky sezon i Serisë A, për ta përforcuar sa më shumë Lazion e cila në sezonin e ardhshëm do të luajë në grupet e Ligës së Kampionëve. Së fundmi në mediat spanjolle kanë qarkulluar zëra se Tare po tenton të transferojë me parametër zero te bardhekaltrit David Silvan i cili do të largohet nga Manchester City në fund të këtij sezoni.

Tifozët në Premierë Ligë pritet të rikthehen më 1 tetor

1 tetori mund të jetë dita e madhe e rikthimit të tifozëve në stadiume. Lajmi që qarkullon prej javësh në mediat angleze është konfirmuar nga sekretari i Sportit, Nigel Huddelstone, i cili u shpreh së fundi se vetëm në fillimin e muajit tetor mund të nisë mbushja e pjesshme e stadiumeve me tifozë në Premierë Ligë. "1 tetori është synimi ynë kryesor. Nëse shikoni disa nga njoftimet tona, disa janë shtyrë në kohë, disa i kemi kthyer pas, por kjo është përfundimtare. Do të isha i habitur nëse kjo datë do të ndryshohej", ka deklaruar Huddelstone.

Sancho preferon Liverpoolin para Unitedit

Ylli i Borussia Dortmundit, Jadon Sancho, ka shkëlqyer në dy sezonet e fundit me klubin gjerman në Bundesliga dhe Ligën e Kampionëve. Forma e tij brilante ka bërë që shumë klube të mëdha evropiane të vihen pas tij, veçanërisht ato angleze të cilat duan ta kthejnë në Ligën Premierë. Javën e fundit është raportuar se Manchester Unitedi është favoriti absolut për transferimin e Sanchos, por tani si duket situata ka ndryshuar. Mediat në Gjermani raportojnë se sulmuesi anësor anglez preferon transferimin te Liverpooli para Manchester Unitedit. Për transferimin e tij skuadra që e dëshiron duhet të paguajë 120 milionë euro.

Thiago kushton 30 milionë euro

Bayern Munchen ia ka caktuar çmimin Thiago Alcantaras i cili dëshiron të largohet këtë verë dhe kërkohet me ngulm nga Liverpooli. Sipas gazetës gjermane "Sport Bild", Bayerni ka vendosur ta shesë mesfushorin spanjoll Thiago Alcantara për 30 milionë euro. 29-vjeçari e ka vetëm edhe një vit në kontratën e tij aktuale me kampionin gjerman dhe është përfolur shumë se ai mund t'i bashkohet Liverpoolit. Thiagos i është ofruar marrëveshje e re në Bayern, por duket se ai ka vendosur ta ndërmarrë një sfidë të re larg Gjermanisë. Duke qenë se verën e ardhshme Bayerni do ta humbiste pa asnjë qindarkë, drejtuesit dëshirojnë ta shesin atë tani. Bayerni synon t'i fitojë 30 milionë euro nga shitja e tij këtë verë. Liverpooli është klubi i vetëm që ka shprehur interesim të madh për të deri tani.

Benzema: Nuk i zëvendësoj katër Ligat e Kampionëve me Kupën e Botës

Karim Benzema nuk pranon t'i shkëmbejë katër Ligat e Kampionëve të fituara me Kupën e Botës të fituar nga Franca në vitin 2018. Sulmuesi i Real Madridit deklaroi se ndihet krenar për historinë që ka shkruar me klubin legjendar të Evropës. Ndër të tjera, ai shton se "Topi i Artë" nuk është obsesion për të. "Topi i Artë? Normalisht, e ëndërroj që në fëmijëri, por nuk është diçka që më bën të çmendem. Roli im në fushë? Nuk e përcaktoj se në çfarë pozicioni luaj, as duke u nisur nga numri (9, 10 apo 11). Jam futbollist dhe jap më të mirën. T'i zëvendësoj katër Ligat e Kampionëve me Kupën e Botës 2018? Jo, nuk më vjen keq aspak. Jam shumë krenar se çfarë kam arritur duke shpallur kampion Real Madridin", ka thënë Benzema, i cili thumbon indirekt Federatën Franceze, e cila e ka përjashtuar pas skandalit të shantazhit të shokut të kombëtares Matjé Valbuena në vitin 2015.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke /
Ministry of Education and Science

29.07.2020

THIRRJE PËR SHPREHJE TË INTERESIMIT-REALIZIMI I VIDEO-MATERIALEVE (NJËSIVE MËSIMORE) SI PJESË E MËSIMIT NGA DISTANCA (E-MËSIMIT)

Ftohen të gjithë mësime të SHFMU të komunave të Kosovës që të aplikojnë për të qenë pjesë e këtij procesi të rëndësishëm për vijimin e mësimit pa ndërprerje në shkollat e Kosovës.

Përshkrimi i angazhimit /termat e referencës:

Mësime të përzgjedhur nga paneli i ekspertëve, do ta realizojnë një cikël të video-njësisë mësimore për nevojat e mësimit nga distanca, duke u bazuar në Kurrikulën e Arsimit Para-universitar dhe në planin e rishikuar me tema e njësi mësimore, për lëndët e ndryshme mësimore në klasë të ndryshme.

Procesi teknik:

Video-ligjëratat do të xhirohen në një lokacion të përcaktuar nga MASH, me laptopë cilësorë përmes platformës Zoom (përmes Zoom recording, screen share, Whiteboard), prandaj këta mësime të cilët do t'i realizojnë xhirimet e video-ligjëratave, do të trajnohen fillimisht për përdorimin e suksesshëm dhe efikas të platformës ZOOM, mënyrën e xhimit të video-ligjëratave me Zoom (me të gjitha opsionet në dispozicion), për përdorimin sa më profesional të kamerës, mikrofonit, touchpadit, sfondit, ndriçimit, si dhe për qëndrimin, pozicionin dhe të folurit gjatë xhimit të video-ligjëratave me Zoom.

Procesi pedagogjik:

Mësime të cilët do të planifikojnë dhe zhvillojnë njësitë mësimore sipas qasjeve metodike të propozuara në kurrikulë, programet lëndore, planifikimet vjetore, dymujore dhe javore, me qasje të integruar dhe me nxënësin në qendër, për një vëllim prej 15 minutash. Në video-njësi duhet të respektohet kjo strukturë:

- Klasa,
- Lënda,
- Emri i njësisë mësimore,
- Rezultati i të Nxënësit të Lëndës (RNL) të cilës i kontribuon njësia mësimore,
- Lloji i njësisë mësimore (zhvillim, analizë, ushtrime, përsëritje, etj.).

Profilin e kandidatëve që kërkohen:

- të jenë të punësuar në sistemin arsimor të Kosovës (dëshmi),
- të jenë të licencuar (dëshmi),
- të jenë të certifikuar për KKK (dëshmi),
- të kenë aftësi të dëshmuara pedagogjike dhe profesionale në lëndën përkatëse,
- të jenë zotërues të mirë të metodologjisë së mësimeve të lëndës përkatëse,
- njohës të mirë të përdorimit të teknologjisë informative (përdorimin sa më profesional të kamerës, mikrofonit, touchpadit, sfondit, ndriçimit),
- të jenë kreativ në zhvillimin e njësisë mësimore dhe instrumenteve për vlerësim e vetëvlerësim,
- të flasin rrjedhshëm dhe qartë, dhe me diksion të drejtë,
- të jenë të përkushtuar dhe të aftë të punojnë në ekip, me orar fleksibël dhe në situata dinamike e me presion të kohës.

Perioda e angazhimit në këtë proces:

- 15 gusht 2020 deri 15 dhjetor 2020, me mundësi vazhdimi.

Procesi i aplikimit:

- Afati i aplikimit: 29 korrik 2020 deri më 5 gusht 2020.
- Forma e aplikimit: video me njësi mësimore 10-15 minuta në gjuhën përkatëse.
- Afati i përzgjedhjes së kandidatëve është: 6,7 gusht 2020.
